



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 2 qershor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Mufera Şinik dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sokol Haziri dhe Daut Morina -KNJ, Hajrush Podvorica – përkthyes, Artan Canhasi – EULEX, Floriana Shala – OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Natyra Kasumaj – KDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.04.2011,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2010,
4. Shqyrtimi detyrave të Komisionit të përcaktuara me planin e Veprimit të Kuvendit, për Integritet Evropian, për tre mujorin e dytë 2011,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27. 04. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27. 04. 2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit për ndihmë juridike, për vitin 2010

Kryetari ftoi Sokol Hazirin ta paraqet arsyetimin e raportit.

Sokol Haziri - E njoftoi Komisionin, me punën e Komisionit për ndihmë juridike. Ai tha se këshilla dhe informacione që iu janë dedikuar palëve për këtë viti është 296 mijë. Rreth vështirësive që ka ky komision mbetet çështja e akomodimit të zyrave, sepse jemi me qira dhe një pjesë e madhe e buxhetit shkon për këtë problem. Në vazhdim përmendi aktivitetit e këtij komisioni, si memorandumet e bashkëpunimit me ministrin e Punës, e kemi finalizuar me anë të memorandumit këtë bashkonim me Fakultetin Juridik me aftësimin e praktikantëve dhe me ministrin e Drejtësisë, dhe me OJQ- të e caktuara. Kemi përfituar një fond prej UNDP- së që na kanë lehtësuar për t'i rritur kapacitetet e zyrave, e që janë kryesisht në vendet ku ka komunitete. Zyrat e krijuara në pjesën veriore, kemi zyrën për ndihmë juridike, pastaj janë zyrat e hapura në Graçanicë, Ferizaj, Dragash dhe Gjakovë. Ai në vazhdim tha se UNDP- ia, ka premtuar që këto zyre të inkorporohen në të ardhmen. Jemi në realizim të një drafti edhe për dy zyra të tjera, një në Viti dhe një në Istog.

Haki Demolli- Theksoi se në përgjithësi raporti pasqyron punën njëvjeçare të këtij komisioni. Raportin e përcjellin disa lëshime të vogla, ka disa detaje të tepërta që e rendojnë raportin, për shembull në faqen 10, ka shumë tabela të prezantuara në raport. Ai adresoi një mori pyetjesh, a ka pasur lëvizje të numrit të personelit, cila është arsyeja e rritjes së pagave, sa është shtimi i numrit të punëtorëve apo cila është arsyeja e kësaj rritje kaq të ndjeshme? Pastaj çështja tjetër, vetëdijesimi i opinionit për çështje juridike. Në raport keni përmend disa prej mënyrave që keni përdor për vetëdijesimin e qytetarëve, lidhur me ndihmën juridike falas, keni pasur ndonjë bashkëpunim ma konkret me shoqërinë civile, në mënyrë që të vetëdijesohet qytetari për ndihmë juridike? Nga raporti shohim se numri i përfituesve gjatë viti 2010 është gati tre fishi i përfituesve, në krahasim me vitin 2009, çka ka ndikuar në këtë rritje?

Arsim Bajrami- Në fjalën e tij tha se është një raport përshkruar i punës së Komisionit. Ai në vazhdim pyeti, ju keni dhënë analizën e rasteve, më intereson, cila kategori e kërkon ndihmën juridike? A vijnë më të varfërit apo vijnë edhe ata që mund të kenë një avokat personal? Ai pyeti edhe për kualitetin e këtyre shërbimeve, sa raste janë ndriçuar kur ju keni ofruar ndihmë juridike falas? Ne jemi të interesuar që kjo ndihmë të funksionoj, por të jetë edhe në nivelin e duhur.

Albulena Haxhiu- Ajo foli për çështjet rreth burimeve njerëzore, ndarjen e buxhetit, ndërsa duke folur për kualitetin e kësaj ndihme tha se nuk është në nivelin e duhur, duhet një bashkëpunim me i madh për të funksionuar ndihma juridike falas. Pyeti se si vjen deri tek avokati?

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se në Komisionin për ndihmë po shoh një avancim në buxhet nga viti i kaluar. Ai kërkoi sqarim se sa është i kompletuar Komisioni për ndihme juridike, te vetëdijesimi, a keni vendos broshura për t'i njoftuar qytetarët që ekziston ndihma juridike falas?

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj Sokol Haziri duke thënë sqarime për secilën nga pyetjet e adresuara.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, e nxori këtë

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i Komisionit të Ndihmës Juridike për vitin 2010, në një nga mbledhjet plenare.

4. Shqyrtimi detyrave të Komisionit të përcaktuara me Planin e Veprimit të Kuvendit

Kryetari e njoftoi Komision me obligimet që Komisionit të përcaktuar me Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritime Evropiane për tremujorin e dytë të vitit 2011. Ai propozoi që për realizimin e këtyre detyrave të kërkohet nga institucionet përgjegjëse një raport i sintetizuar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me integritet evropiane, dhe në kuadër të kësaj, si fazë e dytë të bëjmë edhe dëgjim publik dhe ky dëgjim të jetë i përbashkët, sepse janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Lidhur me këtë propozim anëtarët e Komisionit u pajtuan që të kërkohet raport nga institucionet përkatëse, në afat prej 10 ditësh, të cilat janë të obliguara në përmbylljen e pikave që dalin nga Plani i Veprimit për Integritime Evropiane.

5. Të ndryshme.

Armend Zemaj – Ai e informoi Komisionin se Nënkomisioni për mandate e imunitete dhe rregulloren e Kuvendit më 10 - 11 qershor, do të mbajmë një work- shopin e radhës. Po ashtu sqaroi se e kemi kaluar diku 50% të rregullores.

Kryetari- E vlerësoi të rëndësishme raportimin në Komision, në mënyrë që të jemi të informuar se deri ku ka arritur puna e Nënkomisionit.

Arsim Bajrami- I njoftoi se Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, do të mbajë punëtorinë e parë më 4-5 qershor, andaj jeni të ftuar të merrni pjesë.

Ardian Gjini- Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se jam dakord të kemi agjendën të gjithë anëtarët e Komisionit për të marrë pjesë në takimet tona. Mirëpo jam kundër që të ndërhyhet në punën tonë gjatë kohës sa jemi duke punuar, sepse mund të komplikohet puna.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi